

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga taksat te pagat. Paketa fiskale 2027 në tavolinë, biznesi hap listën e kërkesave
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/nga-taksat-te-pagat-paketa-fiskale-2027-ne-tavoline-biznesi-hap-listen--i589087
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 07:25:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 07:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	89d979cf75e070ba7ea33ba559aa0b2a004fb38c3d808d404cb77a2525a9c50e
TEKSTI	b79f63e200c2902fe54918345b532327bac9c422b6947f8ea69043430a6a5c62
PAMJA	b3dd801f0a58d24b932bcdffcc237320e9c1e314ff2fc5b9ca219b4a2941872c5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02cceed9a00b6a8deb3e80bf745d1a8e59acb3f87b09998b3e761c86026019b9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6f9264c70fd67f9aaea8ca8a31d0350f363dc326e3547de2dbe3cea0108618b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02cceed9a00b6a8deb3e80bf745d1a8e59acb3f87b09998b3e761c86026019b9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by


English

ie [Nga taksat te pagat. Paketa fiskale 2027 ne tavoline, biznesi hap listen e kerkesave](#) "Zverneci". Klosi: "Tradhti kombetare do ishte te mos zhvillohej projekti Debat ne Komis fundit

Nga taksat te pagat. Paketa fiskale 2027 në tavolinë, biznesi hap listën e kërkesave



29 Shtator 2026, 09:25Ekonomia TEMA



Po hyjmë në muajt e fundit të vitit, periudhë kur qeveria finalizon projektbuxhetin dhe paketën fiskale që shoqëron atë.

Me sytë të 2027-a qytetarët presin më shumë mirëqenie, rritje të pagave, pensione dhe përmirësim të shërbimeve publike. Nga na tjetër, bizneset më tepër lehtësi e mbështetje nga qeveria. Manifaktura e bëri hapin e parë duke paraqitur 6 kërkesa, njëra prej të cilave që tatimi mbi të ardhurat të nisë mbi nivelin e pagës minimale, shkruan A2.

"Përllogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga paga të nisë mbi nivelin e pagës minimale dhe që ky prag të ndryshojë automatikisht sa herë ndryshon paga minimale. Kjo masë do të shmangte rritjen automatike të barrës fiskale mbi të ardhurat e punëmarrësve si pasojë e ndryshimit të pagës minimale dhe do të kishte ndikim veçanërisht pozitiv në sektorët me intensitet të lartë punësimi", shprehet Manifaktura Shqiptare.

Nga moslejimi i shitjeve dhe blerjeve me para të huaja, te rregullimi i tregut të akomodimit apo shtimi i subvencioneve, Dhoma e Tregtisë Tiranë dhe 7 shoqata biznesi kanë 20 propozime ligjore të shtrira në katër drejtime për paketën fiskale 2027: "Biznesi ka nevojë për siguri dhe parashikueshmëri. Ndryshimet në taksa dhe detyrime ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si një biznes planifikon investimet, punësimin dhe aktivitetin e tij. Veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme, ndryshimet e shpeshta dhe me pak kohë për t'u përgatitur mund të krijojnë vështirësi dhe kosto shtesë".

Ministria është ende duke dëgjuar institucionet, bizneset apo dhomat e tregtisë. Vullneti për "kënaqje kërkesash" nuk mungon, por pa cenuar objektivat që "financat" kanë.

"Objektivat themelore të miksit të politikave fiskale e monetare 2027 synojnë një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektivi operativ vjetor një balancë primare së paku neutrale. Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 për qind të PBB. Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektivi themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3.0 për qind", tha Ministria e Financave.

Dhoma e Tregtisë dhe shoqatat e biznesit kërkojnë marrjen e masave për uljen e sasisë së parave fizike në qarkullim, hartimin e një plani lidhur me deeuroizimin apo menaxhimin e riskut tatimor sipas gjurmimit të parësë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili, përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%! Piku pritet në dhjetor](#)

08:15 Ekonomia

[Keni një ide biznesi? 1 milion lekë grant nga qeveria - Ibrahimaj: 233 të rinj fitues nga Programi i Vetëpunësimit](#)

16:00 Ekonomia / 2 komente

Stacioni i trenit në Rinas - Shpallet fituesi për projektimin dhe ndërtimin. I hapet rruga lidhjes së kontratës

14:30 Ekonomia / 4 komente

Nafta në kulmin e konsumit? - Zhdoganohen mbi 78 mijë ton në Gusht rritet importi i kafesë dhe birrës

